

**Raporti analitik mbi gjetjet e studimit
cilësor mbi situatën e personave
LGBTI në Shqipëri, Serbi dhe
Maqedoninë e Veriut**

Tiranë, 2019

Hyrje

Në Shqipëri, personat LGBTI+ dhe pakica Rome dhe Egjyptiane, e në mënyrë të veçantë individët që i mbartin njëkohësisht të dyja përkatësitë rezultojnë të jenë midis grupeve më vulnerabël. Nga njëra anë kemi të bëjmë me një pakicë etnike siç janë romët dhe nga ana tjetër me persona që kanë një orientim seksual dhe identitet gjinor të caktuar. Pavarësisht tipareve të ndryshme që mbartin këto dy grupe shoqërore, nga shumë studime dhe raporte institucionale rezulton se pikëtakohen në disa prej problemeve sociale që lindin si pasojë e të qënurit ndryshe në perceptimin e shumicës, e për rrjedhojë shpeshherë të diskriminuar prej tyre. Kjo manifestohet edhe më qartë në personat që janë njëkohësisht LGBTIQ+ ashtu si edhe Rom apo Egjyptian.

Është një dukuri e problematizuar nga studiues të ndryshëm prirja e shoqërisë moderne, të themeluar mbi parimet esencialiste të ideologjisë së shtetit-komb, që të orientohet drejt ruajtjes së puritetit kombëtar në raport me pakicat etnike (Appadurai) ashtu si edhe ndaj çdo grupimi shoqëror që bie ndesh me sistemin dominues vleror. Po ashtu, nga studiues me shumë peshë e me shumë ndikim në rrafshin teorik të trajtimit të pakicave, të cilët kanë ndikuar në ndryshimin e paradigms dhe perspektivës teorike në këtë fushë, sugjerohet që t'i qasemi studimit të kufinjve socialë dhe jo kufinjve etnikë, në rastin e hulumtimit të pakicave etnike (Barth). Megjithëse në këtë rast kemi të bëjmë me dy grupime shoqërore që në premisë janë shumë të ndryshëm, vektori i eksplorimit në disa aspekte të ndërveprimit social të shumicës me pakicën, pavarësisht nëse kjo e fundit buron nga përkatësia e ndryshme etnike apo nga orientimi i ndryshëm seksual dhe gjinor gjasat janë të larta që të përballemi me një korpus problemesh të ngjashme.

Megjithatë duke qenë të vetëdijshëm për kompleksitetin që mbart ky studim, këtu nuk është synuar të rrokën të gjithë variablat e mundshëm dhe aq më pak të analizohen teorikisht, por thjeshtë të identifikohen disa prej problemeve të përbashkëta më të rëndësishme. Domethënë, ky

studim, është më shumë një pikënisje për të shquar se cilat janë problemet e përbashkëta më akute, të identifikuara si të tilla nga pjesëtarët e të dy grupeve ashtu si edhe në mënyrë të veçantë nga individët që i mbartin të dyja përkatësitë. Këto gjetje mund të shërbejnë (ashtu si edhe në hulumtime të ngjashme) si për të hartuar politika dhe strategji ndërhyrjeje me synim përmirësimin e jetesës së këtyre grupeve ashtu edhe si linja potenciale për studime më të thelluara në të ardhmen.

Një tjetër element i rëndësishëm që është konsideruar në konceptimin e këtij studimi, është heterogjeniteti i këtyre grupeve: Së pari duke e lexuar këtë karakteristikë si një fakt social të pashmangshëm, si një atribut që potencialisht shumë prej grupimeve shoqërore në kushtet e lirisë e mbartin në vetvete. Së dyti, sepse siç dihet, në mënyrë të veçantë në raport me minoritetet, diversiteti përbën njëkohësisht edhe principin themelor, si një parakusht për krijimin e botëve që mundësojnë akomodimin e “të ndryshmes”. Për pasojë çdo perspektivë që i qaset këtyre grupimeve shoqërore si komunitete homogjene, rrezikon të asgjësojë jo vetëm atë çfarë në vetvete këto grupe shoqërore e mbartin si vlerë por edhe një parim të rëndësishëm për vetë ekzistencën e këtyre grupeve. Së treti, njohja e heterogjenitetit implikon edhe vetëdijen për kompleksitetin që mbart nyjëtimi i problemeve shumë shtresore dhe nuancave që nuk mund të pretendohet të rroken në një studim. Për shembull, varet nga statusi apo pozita shoqërore që ka secili prej individëve në shoqëri që është pjesë e të tre grupeve (Romët, LGBTIQ+, dhe individët që i mbartin të dyja përkatësitë, të cilët përbëjnë një grup të tretë në këtë studim), pasi shtresa më e varfër apo klasa më e ulët e tyre përballat me të tjera probleme krahasuar me shtresën e mesme apo të lartë. Po e njëjta vështirësi ekziston edhe në rast krahasimi midis individëve që i pëkasin të njëjtës shtresë sociale nga të tre grupet, sepse në shumë raste mund të kenë mundësi të ndryshme rrethore që e favorizojnë ose e pengojnë mobilitetin e tyre social, raportin me shumicën e popullatës apo me mjedisin social në përgjithësi.

Gjithsesi, siç pasqyrohet edhe më lart ky studim niset nga premisa se të tre grupet përballen me probleme të ngjashme si pasojë e raportit me shumicën e popullatës dhe me strukturën sociale. Synimi kryesor i këtij studimi është të zbulohen problemet e përbashkëta që lindin si rezultat i përjashtimit të pakicës prej shumicës dhe prej strukturës sociale e cila ndërtohet mbi marrëdhënien e pushtetit. Duke u nisur në këtë arsyetim, prej supozimit se marrëdhëniet e pushtetit mbështeten në sistemin vleror dominues, kulturën dominuese, apo burime të tjera që farkëtojnë këtë marrëdhënie, sjellin si shpesh herë përjashtimin dhe nënrenditjen e grupeve të caktuara për shkak të racës, ngrës së lëkurës, gjinisë dhe orientimit seksual. Siç edhe theksohet më lart kjo vlen veçanërisht për individët që i mbartin të dyja përkatësitë.

Metodologjia

Ky është një studim cilësor, i realizuar në tre shtete, Shqipëri, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Për mbledhjen e të dhënave është përdorur teknika e fokus-grupeve dhe intervistave të thelluara. Si për intervistat e thelluara ashtu edhe për fokus-grupet u hartua një guidë pyetjesh, e cila gjendet në aneksin e këtij raporti.

Në secilin prej shteteve është realizuar një fokus – grup dhe tre intervista të thelluara. Fokus-grupet përbëheshin nga aktivistë të shoqërisë civile nga pakica rome (në rastin e Shqipërisë edhe nga pakica Egjyptiane) ashtu si edhe nga aktivistë LGBTIQ+. Fokus-grupi u strukturua në këtë mënyrë për katër arsye:

- 1) Mbështetur në marrëdhënien e tyre të afërt me individë të të dy pakicave, mundësohej njohja nga afër me problemet kryesore me të cilat përballen komunitetet në fjalë ;

- 2) Mbështetur në përvojën e tyre mundësohej një njohje më e thelluar e problemeve dhe për rrjedhojë edhe e shkaqeve dhe pasojave;
- 3) Përmes analizës mund të identifikoheshin problemet e përbashkëta të dy pakicave ashtu si edhe të diskutoheshin zgjidhjet e mundshme
- 4) Kjo metodë shërben si një mënyrë për të eksploruar dinamikat e brendshme dhe për të kuptuar se çfarë mund të përmirësohet në veprimtarinë e një aktori me peshë, si organizatat e shoqërisë civile, për të ndikuar në përmirësimin e jetesës së pakicave.

Intervistat janë realizuar me individë që janë njëkohësisht Rom apo Egjyptian dhe LGBTIQ+ me synimin për të kuptuar shtrirjen dhe natyrën e problemeve të shumëfishta me të cilat përballen individët që i mbartin të dyja përkatësitë.

Gjetjet kryesore

Sipas një personi transgjinnor në Shqipëri që është njëkohësisht edhe aktiviste e të drejtave të komunitetit LGBTIQ+, tre problemet kryesore me të cilat përballlet ky komunitet të renditura sipas rëndësisë janë: strehimi, ofrimi i shërbimeve dhe punësimi.

“Mua si person transgjinnor, për të zhvilluar identitetin tim m`u desh të shkëputesha nga familja dhe momentalisht jetoj në një shtëpi me qera. Ky proces ka qenë tepër i vështirë pasi sapo qiradhënësit mësonin se isha transgjinnore nuk pranonin të banoja në objektet e tyre, madje disa herë kam paguar dhe nuk më kanë kthyer as lekët, duke më nxjerrë nga shtëpia” shprehet personi në fjalë.

Nga arsyetimi evidentohet qartësisht që në të vërtetë këto probleme në rastin e personave transgjinnorë janë pasojë, sepse shkak është diskriminimi.

Sipas një aktivisteje romë nga Shqipëria problemet kryesore janë: Strehimi, punësimi, shkollimi, diskriminimi dhe martesat në moshë të mitur. Një tjetër aktiviste romë duke ju referuar përvojës së saj personale thotë se: *“Diskriminimi më bëri ta lija shkollën. Në shkollën time kam qenë e vetmja nga komuniteti rom. Shokët e klasës dhe mësuesit më referoheshin me epitete të ndryshme.”*

Në Maqedoninë e Veriut, nga fokus-grupi, personat LGBTIQ+ listojnë si problemin kryesor mungesën e mbrojtjes ligjore dhe përjashtimin nga shteti. Po ashtu, si në rastin e Shqipërisë, nga analiza e pjesëmarrësve në fokus-grupe rezulton se shkak kryesor i të gjitha problemeve me të cilat përballlet ky grup është diskriminimi. Po ashtu, në lidhje me Romët, një nga pjesëmarrëset në fokus-grup u shpreh : *“Problemi kryesor me të cilin përballen romët është edukimi, por diskriminimi është shkak. E njëjta gjë vlen edhe për LGBTIQ+”*.

Në Serbi problemet kryesore që u listuan prej aktivistëve pjesëmarrës në fokus-grup në lidhje me LGBTIQ+ janë injoranca (si mungesë informacioni apo njohjeje në lidhje me këtë grup) stereotipizimi dhe diskriminimi. Po ashtu, për romët u përmendën si probleme kryesore diskriminimi, paragjykimet e rrënjëzuara thellë, dhe injoranca e përgjithshme në raport me këtë grup¹.

Veçoritë dhe të përbashkëtat midis Romëve dhe LGBTIQ+

Duke diskutuar problemet e përbashkëta një aktiviste për të drejtat e LGBTIQ+ nga Shqipëria u shpreh: *“Një e përbashkët e madhe është diskriminimi që sjell më pas probleme të tjera si mohimi i aksesit në strehim, arsim dhe papunësia”*.

Gjithashtu, një gjetje mjaft domethënëse që filtrohet nga diskutimi i zhvilluar përgjatë fokus-grupit në Shqipëri është graviteti që mbart varfëria si një prej burimeve kryesore të shumë prej

¹ Të gjitha të dhënat mbi fokus-grupin e zhvilluar në Serbi mbështeten në raportin e përgatitur nga grupi i Serbisë.

problemeve me të cilat përballen të tre grupet. Nga arsyetimi i pjesëmarrësve dhe përvojat e tyre të drejtpërdrejta rezulton se varfëria është edhe shkaku kryesor i diskriminimit. Kjo reflektohet në faktin që dallohen diferenca në marrëdhënien midis individëve që janë pjesë e këtyre grupeve dhe shumicës së popullatës, të kushtëzuara nga gjendja ekonomike e individit. Një aktiviste romë duke u mbështetur në përvojën e saj të fëmijërisë, gjatë kohës që frekuentonte shkollën nënvizon që: *“Unë e konsideroj varfërinë si një nga shkaqet kryesore të diskriminimit pasi dhe në rastin tim, nëse do kisha mundësi më të mira ekonomike, do të kisha veshje më të mira dhe nuk do ndjehesha ndryshe nga bashkëmoshatarët, të cilët më vinin shpesh në shënjestër.”*

Ndërsa një person transgjinnor pohon: *“Ka konflikte brenda komunitetit dhe shtresëzime në bazë të gjendjes ekonomike. Një pjesë e ka jetën shumë më të lehtë dhe dallimet janë tepër të forta. Kjo sjell shpesh edhe diskriminim mes vetë pjesëtarëve të komunitetit.”*

Gjithashtu, veçori që theksohej gjatë diskutimit në fokus-grup, si shprehje e dallimeve midis romëve dhe personave LGBTIQ+ në Shqipëri, është mënyra se si trajtohen prej tjetrit që nuk është pjesë e këtyre grupeve. Për shembull, një aktiviste e të drejtave të personave LGBTIQ+ me një përvojë të gjatë në organizata të ndryshme jo fitiprurëse, u shpreh: *“Kam vënë re se qasja e profesionistëve ndaj komunitetit LGBTIQ+ dhe atij rom/egjiptian është e ndryshme. Zakonisht në ambiente ku ka profesionistë dhe flitet për komunitetin rom dhe egjiptian, ata përpiqen të jenë të kujdesshëm, kurse lidhur me komunitetin LGBTIQ+ kjo pothuajse nuk ndodh.”*

Një tjetër veçori dalluese në rrafshin e problemeve me të cilat përballen këto grupe, është marrëdhënia me familjen. Për të dyja grupet, referuar aktivistëve rezulton se familjet nuk i mbështesin shumë fëmijët e tyre në raport me shkollimin. Për shembull në rastin e romëve, si pasojë e mendësisë, sapo vajzat arrijnë në moshën e pubertetit detyrohen prej prindërve që të largohen nga shkolla. Në rastin e personave LGBTIQ+, gjendja e tyre në këtë moshë është edhe më e rëndë, me shumë pasoja edhe për të ardhmen, sepse përpos faktit se janë viktima të bulizimit

nga bashkëmoshatarët e tyre dhe shpesh herë e diskriminimit nga mësuesit, përgjithësisht nuk gëzojnë as mbështetjen e prindërve. Kjo shprehet mjaft qartë nga një prej aktivisteve e cila u shpreh: *“Duke qenë se shumica e prindërve të personave LGBTIQ+ nuk janë mbështetës ndaj fëmijëve të tyre, nuk i ndihmojnë ata me problemet e ndryshme që mund të kenë në ambientin e shkollës. Ata zgjedhin thjesht të mos shfaqen aty dhe problemet e fëmijëve të tyre thellohen.”*

Në Maqedoninë e Veriut evidentohen si probleme të përbashkëta të tre grupeve diskriminimi, mungesa e mbrojtjes ligjore dhe vetëdiskriminimi apo vetëstigmatizimi nga individët që janë pjesë e këtyre grupeve. Po ashtu, edhe në këtë rast, prej aktivistëve shquhen veçori dalluese për disa prej tipologjive të problemeve me të cilat përballen të dy grupet. Një aktivist Rom shprehet se: *“Megjithëse romët janë familjarë, ata nuk duan të përpiqen më shumë për të zgjidhur problemet e tyre. Ekzistojnë shërbimet, por ata nuk duan që të informohen më shumë dhe t’i marrin këto shërbime”.*

Në Serbi ka një dallim përse i përket raportit me të kaluarën komuniste të ish-Jugosllavisë. Romët shprehen se jetonim më mirë në sistemin komunist sepse ishin më pak të diskriminuar, ishin të punësuar dhe gëzonin një gjendje ekonomike më të mirë. Ndërkohë që në ish-Jugosllavinë komuniste homoseksualiteti ishte i ndaluar me ligj dhe trajtohej si krim. Madje ky ligj vijonte të ishte në fuqi gjer në vitin 1994, vit në të cilin homoseksualiteti u dekriminalizua. Ndërkohë që e përbashkëta mes dy grupeve, ashtu si edhe në dy vendet e tjera rezulton të jetë para së gjithash diskriminimi.

Në të tre vendet u vërejt që aktivistët pjesëmarrës në fokus-grupe e kishin më të thjeshtë që të evidentonin të përbashkëtat se sa dallimet. Dallimet si midis grupeve ashtu edhe shpeshherë brenda grupeve ekzistojnë, por prirja e shfaqur gjatë diskutimeve për t’i tejkaluar shpejt dallimet, manifeston një fenomen për tu nënvizuar - në esencë problemet e grupeve të diskriminuara dhe të margjinalizuara janë të ngjashme.

Në të tre vendet është e qartë se janë disa faktorë që e vështirësojnë mirëqënien ekonomike, sociale e psikologjike të pakicave në përgjithësi, pavarësisht dallimeve midis tyre. Nuk është rasti për shkak të kufizimeve të objektit të këtij teksti, që të lëvrohet një analizë e hollësishme e këtyre faktorëve. Por, nga ana tjetër, nxitur nga gjetjet e këtij studimi nuk mund të injorohet qoftë edhe listimi i këtyre faktorëve. Këtu, nuk bëhet fjalë për tu ndalur në shkaqet që kanë favorizuar lindjen e këtyre problemeve apo shumë të tjerave që nuk përmenden në këtë studim. Kjo, sepse del jashtë pretendimeve modeste të këtij studimi, duke konsideruar kompleksitetin që mbart një analizë e këtyre përmasave ashtu si edhe shtrirjes së debatit teorik që implikon. Mjafton të mbahet parasysh se për sa kohë në historinë e njerëzimit dhe jo vetëm, në vendet e përfshira në këtë studim, homoseksualiteti është konsideruar një sëmundje, dhe si sot e kësaj dite në shumë vende personat LGBTIQ+ dhunohen barbarisht dhe diskriminohen në mënyra të ndryshme për shkak të orientimit seksual apo identitetit gjinor. Po ashtu mjafton të kujtojmë se si për shumë kohë romët kanë qenë të dëbuar nga shtete të ndryshme, se sa prej tyre u vranë prej holokaustit, apo se si edhe në vitet e fundit janë shpeshherë viktimat e dhunës dhe dëbimeve masive në shtete të rajonit dhe më gjerë (Liegeois 2007).

Sfida, vështirësi, pengesa dhe praktika të suksesshme.

Kësisoj, duke u ndalur vetëm në shquarjen e faktorëve aktualë që ndikojnë në kultivimin e problemeve me të cilat përballen të tre vendet, mbështetur në gjetjet e këtij studimi, faktorët mund t'i ndajmë në dy kategori:

- 1) Faktorë apo shkaqe të prodhuara nga jashtë këtyre grupeve si: Keqfunksionimi i shtetit i reflektuar në mungesën e ligjeve dhe politikave të përshtatshme ashtu si edhe e mangësive në zbatimin e këtyre ligjeve apo politikave. Praktikisht, këto do të ndihmonin në reduktimin e problemeve me natyrë sociale, ekonomike, politike e psikologjike të këtyre pakicave.

- 2) Faktorë apo shkaqe të prodhuara së brendshmi si: a) Në nivel individual, si vetëstigmatizim, pranimi i gjendjes ekzistuese dhe mungesa e vullnetit për të vepruar për ndryshimin e situatës; b) Në nivel kolektiv, pamundësia dhe në disa raste mungesa e vullnetit për tu organizuar dhe mobilizuar për kauzat e përbashkëta. Organizimet formale të llojit OJF, pavarësisht shumë përpjekjeve pozitive me synim ndryshimin e gjendjes, nuk arrijnë të tejkalojnë shpeshherë problemet e brendshme të karakterit organizativ, probleme me metodologjinë apo instrumentat e përdorur ashtu si edhe probleme me lidërshtipin dhe vendimarrjen.

Përpos problemeve që burojnë prej shtetit të cilat theksohen prej të gjithë aktivistëve pjesëmarrës në fokus-grupe si pengesë e rëndësishme në ndryshimin e realitetit në të cilin jetojnë këto pakica, një vend të rëndësishëm në kultivimin e problemeve aktuale apo atyre të akumuluar në kohë zënë edhe pengesat e brendshme. Mbështetur në përvojën e tyre jetësore, shumë prej aktivistëve nënvizojnë rëndësinë e ndryshimit nga brenda këtyre grupeve si përse i përket komunitetit ashtu edhe organizatave që supozohet të ndihmojnë për të ndryshuar gjendjen e këtyre pakicave.

Një aktiviste e një organizate që punon për të drejtat e LGBTIQ+ në Shqipëri tha që: *“Organizatata janë kryesisht të udhëhequra nga pikëvështrimet e donatorëve, të cilët financojnë shumë për ngritjen e kapaciteteve, trajnime e ëorkshop-e, të cilat janë instrumenta shumë pozitive, por nuk sjellin rezultate të qëndrueshme. Ndërkohë ka pjesëtarë të komunitetit që gjenden në situata tepër të vështira, ku nuk u përmbushen as nevojat bazike, të cilët nuk ndihmohen realisht, pasi burimet e financimit nuk shkojnë drejtpërdrejt për komunitetin. Nëse individët nuk gëzojnë as të drejtat bazë dhe kushtet minimale të jetesës nuk mund të pretendojnë fuqizimin e tyre. Vetë komunitetet duhet të ndërjegjësohen dhe të organizohen për të kërkuar të drejtat e tyre, duke ushtruar presion aty ku duhet”.*

Një aktivist nga Maqedonia e Veriut pohoi që: *“Ekzistojnë organizata jo qeveritare rome që kanë buxhete të mëdha por nuk fokusohen në çështjet e duhura. Mendoj që përfshirja e pamjaftueshme në sektorin publik është arsyeja kryesore se përse këto probleme zhvillohen, ndaj dhe edukimi është i nevojshëm për të tejkaluar këto probleme.”*

Aktivistët nga Serbia theksojnë: *“ Duhet së pari të jemi krenar për atë që jemi”* sepse nuk ka asgjë të keqe apo arsye për të ndjerë në turp nëse je LGBTIQ+ apo Rom”.

Në lidhje me organizatat jo fitim-prurëse apo jo-qeveritare shprehen se: *“ Para disa vitesh organizatat e angazhuara për çështjen LGBTIQ+ nuk ishin të hapura dhe transparente kundrejt komunitetit. Pothuajse të gjitha këto organizata kanë manifestuar mungesë vullneti për tu angazhuar me të rinjtë LGBTIQ+.”*

Ndërsa aktivistët për e komunitetit rom janë mjaft kritikë ndaj veprimtarisë së organizatave jo-qeveritare dhe dakordësohen në disa aspekte si: organizatat janë të ngadalta dhe burokratike, mungojnë organizatat rinore rome, nuk ka të rinjë vullnetarë, dhe disa prej organizatave aktivizohen vetëm në ditën ndërkombëtare të Romëve.

Një prej problemeve më serioze që evidentohet prej aktivistëve është humbja e besimit të komuniteteve respektive tek organizatat dhe për pasojë mungesa e përfshirjes së vetë komuniteteve. Në këtë prizëm një aktiviste Rome nga Shqipëria u shpreh se: *“ Tani komuniteti ka filluar të ketë më shumë besim, por ka qenë e vështirë të komunikoje me ta në fillim. Gjëja e parë që të thonin kur merrnin vesh që jemi nga një organizatë ishte që keni ardhur të na vidhni”.*

Një aktiviste për çështjen LGBTIQ+ nga Maqedonia e Veriut pohoi se: *“ Komuniteti nuk përfshihet në hartimin e planeve të organizatave dhe për pasojë mungon besimi dhe angazhimi i komunitetit në veprimtarinë e këtyre organizatave..”*

Një aktivist rom në Serbi tha që: *“Situata është aq e rëndë në kuadrin e raportit të besimit midis organiztave dhe komunitetit, sa që shpesh herë për aktivistët e angazhuar në organizata është vështirë edhe të hyjnë në vendbanimet e romëve sepse komuniteti nuk i pranon”.*

Pavarësisht kushtëzimeve, prej aktivistëve identifikohen disa prej inisiativave të suksesshme të cilat kanë prodhuar rezultate pozitive. Këto inisiativa, me kohën mund të përmirësohen më shumë apo mund të kthehen në praktika të qëndrueshme.

Një aktiviste për personat LGBTIQ+ në Shqipëri, evidenton si një prej praktikave më të suksesshme atë që e cilësojnë si metoda e shoqërimit duke thënë: *“Metoda e shoqërimit ka funksionuar. Kur ofruesit e shërbimit dëgjojnë se vjen nga një organizatë që mbron të drejtat e një komuniteti të caktuar, stepen nga frika se do ketë publicitet të abuzimit dhe detyrohen ta ofrojnë shërbimin.”*

Ndërsa një aktiviste për të drejtat e komunitetit Rom identifikon si një prej zhvillimeve më pozitive punën e zhvilluar për përmirësimin e strehimit për pakicën rome. Ajo shprehet që: *“Ne kemi bërë shumë progres për çështjen e strehimit. Kemi arritur të sigurojmë banesa të qëndrueshme për rreth 150 familje në Tiranë. Kemi lobuar për të ndryshuar ligjin për strehimin social dhe për ta përmirësuar atë.”*

Një aktivist nga Maqedonia e Veriut, duke vlerësuar fillimisht pengesat në zgjidhjen e problemeve të ndryshme identifikoi një rast suksesi duke pohuar që: *“Disa prej problemeve janë zgjidhur plotësisht, disa pjesërisht, në varësi të problemit dhe mënyrës si është adresuar ai. Për shëmbull, problemi me mungesën e gjinekologut për një komunitet romësh që banon në një zonë të quajtur Shuto Orizari është zgjidhur pjesërisht, sepse mjekja e caktuar nuk njeh gjuhën Maqedonase dhe pacientët nuk mund të komunikojnë me dikë që nuk njeh gjuhën. Megjithatë*

shumë prej problemeve tona janë zgjidhur megjithëse njerëzit kanë humbur motivimin për të raportuar problemet e tyre.”

Aktivistët LGBTIQ+ në Serbi bien dakord që parada e krenarisë është mjete më i mirë për të shkurtuar distancën sociale dhe eventit më vizibël i LGBTIQ+ në Serbi.

Ndërsa aktivistët Rom në Serbi ndajnë mendimin se angazhimi në punë me të rinjtë Rom, identifikimi i rasteve të diskriminimit janë instrumentat më të rëndësishëm për përmirësimin e pozitës së komunitetit Rom.

Çfarë mund dhe duhet të përmirësohet?

Në diskutimet e zhvilluara në fokus-grupe, aktivistët u ftuan veç të tjerash që të arsyetonin në raport me mundësitë e përmirësimit të situatës në një plan realist, përmes një vlerësimi objektiv të mundësive dhe kushteve ekzistuese. Gjithashtu, në një rrafsh idealist si projeksione të një shoqërie më të drejtë në të cilën pakicat nuk përballen me vështirësitë aktuale. Në këtë linjë arsyetimi dhe analize synohej që gradualisht të mbërrihej edhe në shqyrtimin e mundësive për iniciativa të përbashkëta të dy grupeve duke vlerësuar pikëtakimet e vizionit për të tashmen dhe të ardhmen në përmirësimin e jetesës së këtyre grupeve.

Në arsyetimin mbi raportin shtet -pakica, pavarësisht disa përmirësimeve formale rezulton se (megjithë dallimet e vogla midis të tre vendeve) sipas këndvështrimit të aktivistëve në të tre vendet, mënyra e funksionimit të shtetit paraqet mjaft probleme. Në Shqipëri ka përmirësime të dukshme në aspektin e përmirësimit të bazës ligjore por këto janë vetëm ndryshime formale sepse mungon angazhimi dhe vullneti për t'i zbatuar në praktikë.

Në këtë aspekt një aktiviste LGBTIQ+ në Shqipëri u shpreh se: *“Për komunitetin LGBTIQ+ ekzistojnë disa produkte shumë të mira të nismave ligjore, siç është ligji për mbrojtjen nga diskriminimi apo plani kombëtar i veprimt për personat LGBTI, i cili përfshin mundësinë për*

akses në një sërë shërbimesh. por, mendoj se fokusi i shtetit tonë duhet të jetë më praktik dhe të drejtohet më tepër nga implementimi dhe ekzekutimi i drejtë i këtyre akteve me karakter juridik”.

Ndërsa një aktiviste rome u shpreh se: *“Do të ishte shumë mirë sikur personat që punojnë në institucione të ndryshme të na orientonin drejt gjërave që na ndihmojnë, institucioneve apo personave të duhur. Ka raste që e bëjnë, por shumicën e kohës jo”.*

Aktivistët në Maqedoninë e Veriut shprehen se disa përmirësime në legjislacion kanë ndodhur, por është akoma e nevojshme që të bëhen ndryshime si në përmirësimin e bazës ligjore ashtu edhe në zbatim.

Një Aktiviste LGBTIQ+ u shpreh që: *“Qeveria premtoi të përmbushte diçka përpara zgjedhjeve, dhe rezultati është që kemi dy draft-ligje që presin dhe me sa duket janë thjeshtë premtime boshe”.*

Një aktiviste Rome u shpreh: *“Mbështetja ndërkombëtareka më shumë ndikim në zhvillimin e komunitetit Rom se sa qeveria. Ndoshta donatorët e huaj duhet ta inkurajojnë qeverinë që angazhohet më shumë në këtë aspekt.”*

Në Serbi shumica e aktivistëve, duke arsyetuar mbi aspektet në të cilat mund të përmirësohet ndërhyrja e shtetit bashkohen në disa linja si: Zbatimi i plotë dhe i qëndrueshëm i ligjit, ndërhyrje për ndalimin e dhunës ndaj LGBTIQ+, si dhe nevoja që personat LGBTIQ+ brenda qeverisë të jenë më të zëshëm në lidhje me kauzën e këtij grupi.

Ndërsa aktivistët Rom në Serbi ishin edhe më kritik ndaj qeverisë pasi të gjithë ndanin të njëjtin mendim përse i përket faktit që shteti duhet të bënte shumë më tepër për përfshirjen e Romëve. Sipas tyre problemi i parë që duhet të zgjidhë shteti është strehimi i Romëve duke ofruar mundësi reale për banim, ashtu si edhe ligje dhe strategji të përshtatshme. Në këtë prizëm njëri

nga aktivistët Rom duke sjellë përvojën e tij si nëpunës publik u shpreh që: *“Strategjia e dikurshme për përfshirjen e Romëve 2009-2015 dështoi në adresimin e shumë çështjeve dhe disa qëllime të strategjisë nuk u përmbushën, veçanërisht ato në fushën e edukimit dhe të punësimit”*.

Aktivistët në të tre shtetet arsyetojnë edhe mbi disa elementë që mund të përmirësohen në aktivitetin e OJF-ve. Në Shqipëri aktivistët e të dy pakicave bien dakord se është shumë e rëndësishme të ndryshojë qasja e organizatave në raport me donatorët dhe komunitetin. Më konkretisht, shumica e aktivistëve shprehen se organizatat nuk duhet të udhëhiqen nga këndvështrimi dhe përparësitë e donatorëve por nga nevojat dhe interesat e komunitetit.

Në Maqedoninë e Veriut shumica e aktivistëve nga të dy grupet ndajnë të njëjtin mendim përse i përket nevojës që organizatat të orientohen më shumë në advokim, dhe mbi të gjitha të fokusohen në rritjen e pjesëmarrjes së komuniteteve me të cilat punojnë.

Në Serbi, nga aktivistët e të dy grupeve theksohet nevoja e përmirësimit të komunikimit dhe rritjes së përfshirjes së komuniteteve në mënyrë që të reduktohet apo të eliminohet problemi i mungesës së besimit të komuniteteve në organizatat jo fitimprurëse apo jo qeveritare.

Projekte dhe projeksione të përbashkëta

Aktivistët përmes analizës që sjellin në diskutimet e zhvilluara në fokus-grupe, përveçse reflektojnë mbi të tashmen dhe të shkuarën, artikulojnë edhe projeksionet e tyre për të ardhmen. Kjo bëhet veçanërisht, duke vlerësuar edhe mundësinë e bashkëpunimit midis aktivistëve dhe organizatave të të dy pakicave. Referuar aktivistëve projekte të përbashkëta bashkëpunimi mund të ndihmojnë së pari për tu njohur më mirë dhe për të rritur solidaritetin midis të dy pakicave, duke krijuar në këtë mënyrë kushtet për të vepruar bashkarisht në rritjen e peshës së grupeve të marginalizuara në hapësirën publike dhe për rritjen e presionit ndaj organeve vendimarrëse.

Në këtë kuadër, në Shqipëri aktivistët nga të dy pakicat diskutuan se si mund të transferohen dhe të integrohen në veprimtarinë e tyre përvoja e fituar nga secili prej aktivistëve në punën e bërë me komunitetet përkatëse. Më konkretisht, një aktiviste Rome u shpreh se: *“Mendoj se një projekt i përbashkët do të ishte një mundësi shumë e mirë solidarizimi. Përmes strategjive të përdorura nga ne (aktivistët Romë) në përfitimin e shërbimeve publike, mund të ndihmojmë personat LGBTIQ+ të jenë më të suksesshëm përballë ofruesve të shërbimeve.”*

Një tjetër aktivist Rom u shpreh se: *“Mendoj se komuniteti rom mund ta ndihmojë komunitetin LGBTIQ+ në lidhje me aksesimin e strehimit social. Duke qenë se ne kemi shumë kohë që përpunojmë strategji dhe na rezultojnë efektive në këtë drejtim, mund t’ua përcjellim ato personave të komunitetit LGBTIQ+ me shpresën që edhe ata do mund t’i zgjidhin problemet e tyre lidhur me strehimin.”*

Duke u mbështetur në përvojën e saj një aktiviste për të drejtat e LGBTIQ+ tha që: *“Në nivel organizatash puna që komuniteti LGBTIQ+ ka bërë me fushatat anti-diskriminim është shumë më e madhe dhe evidente krahasuar me komunitetin rom/egjiptian. Gjithashtu edhe bashkëpunimi me organizatat që mbrojnë të drejtat e grave ka qenë shumë i mirë. Mendoj se komuniteti rom/egjiptian mund të përdorë eksperiencat e komunitetit LGBTIQ+ në këtë pikë. Të dy komunitetet kanë shumë për t’i mësuar njëri-tjetrit nga pikëpamja e guximit për të kërkuar të drejtat respektive.”*

Në Serbi, mbështetur në qëndrimet e aktivistëve, problemi thelbësor mbetet depërtimi në institucionet e edukimit për tu mësuar nxënësve rreth diskriminimit, duke qenë se këto çështje nuk janë të përfshira në kurrikula. Gjithashtu nevojitet bashkëpunim me mediat dhe gazetarët në lidhje me këtë çështje. Gjatë fokus-grupit në Serbi aktivistët LGBTIQ+ njohën aktivistët Rom me përvojën e tyre në korigjimin e teksteve të librave me përmbajta homofobike duke diskutuar

mbi hapat konkretë që mund të ndërmerren edhe nga aktivistët Rom për ndërhyrjen në tekste me përmbajtje që i portretizon romët në një mënyrë negative.

Intervistat me persona Rom/Egjyptian dhe LGBTIQ+

Në të tre shtetet rezulton se problemi kryesor për personat që i mbartin të dyja përkatësitë është diskriminimi i skajshëm dhe i shumanshëm.

Shumë prej tyre janë diskriminuar nga familjarët, të afërmit dhe të njohurit, nga nxënësit e tjerë në shkollë, në vendin e punës ose gjatë përpjekjeve për tu punësuar në një institucion shtetëror apo sipërmarrje private. Pavarësisht se historitë jetësore të individëve të intervistuar janë të ndryshme, si pasojë e mjedisit familjar në të cilin janë rritur, e kontekstit në të cilin kanë jetuar, edukimit personal, personalitetit dhe mënyrës së reagimit ndaj sulmeve personale, të gjithë rrëfyen që kanë qenë viktimë të diskriminimit, përjashtimit dhe në shumë raste edhe të dhunës fizike.

Në Shqipëri u zhvilluan tre intervista: Me një grua egjyptiane transgjimore rreth 35 vjeçe dhe dy gra të tjera egjyptiane biseksuale 19 dhe 23 vjeç. Një nga të intervistuarit e ka ndërprerë intervistën në pyetjet e para ndaj do të sillet vetëm pasqyrimi i gjetjve mbështetur në dy intervista.

Njëra nga të intervistuarat aktualisht është e pastrehë, jeton e vetme dhe nuk ka bërë asnjë vit shkollë. E vetmja punë që ka arritur të sigurojë (me një pagë modeste prej 20.000 lekësh në muaj) është pranë një organizate që kujdeset për personat LGBTIQ+. Familja e ka braktisur sapo është njohur me orientimin e saj seksual. Ajo tregoi se identiteti i saj gjinor ka ndikuar negativisht në të gjitha aspektet e jetës dhe se diskriminimi rritet duke qenë njëkohësisht person me një etni tjetër dhe gjithashtu e pastrehë. Vështirësitë kryesore me të cilat përballlet aktualisht janë mungesa e shërbimit shëndetësor, mungesa e të ardhurave financiare dhe mungesa e strehimit.

Në rastet kur diskriminohet apo dhunohet i drejtohet për ndihmë organizatave sepse edhe në polici përballtet me diskriminim. Ajo mendon se shteti duhet t'i sigurojë kushtet bazike si strehimi dhe shëndetësia. Sipas saj, organizatat jo fitim prurëse kanë qenë e vetmja ndihmë për të për gjatë gjithë jetës.

E intervistuar e dytë, ka kryer shkollën e mesme, jeton vetëm, aktualisht është e papunë dhe për të jetuar mbështetet te familja e saj. Orientimin e saj seksual e ka kuptuar në moshë të hershme dhe është ndjerë euforike dhe e frikësuar njëkohësisht. Disa prej të afërmeve dhe të njohurve e kanë pranuar pasi janë njohur me orientimin e saj seksual disa të tjerë e kanë ngacmuar dhe kanë ushtruar bullizëm. Ndërsa në shkollë pohon se nuk është ndjerë mirë pasi nxënësit e tjerë e kanë diferencuar për shkak të prejardhjes dhe orientimit të saj seksual. Gjithashtu edhe në ambientet e punës është përballur me homofobi dhe bullizëm në atë masë sa është detyruar që të largohet nga puna. E intervistuar thekson se pasja e të dyja përkatësive ndikon jashtëzakonisht shumë negativisht, sepse kur mësojnë që je Rome dhe LGBTIQ+ nuk të punësojnë ose gjejnë mënyrat që të të largojnë nga puna. Vështirësitë më të mëdha me të cilat përballtet aktualisht, veçanërisht për shkak të orientimit të saj seksual janë përjashtimi nga një pjesë e shoqërisë, konfliktet me familjen dhe papunësia. Sipas saj, shteti duhet të ofrojë shëndetësi falas për të gjithë pavarësisht orientimit seksual apo përkatësisë etnike dhe duhet të përmirësohen kushtet spitalore mbasi janë në gjendjeskandaloze. Ndërsa për organizatat, duke i parë si të vetmen shpresë e intervistuar u shpreh se: *“Organizatat duhet të punësojnë persona LGBT në mënyrë që ata të jenë të pavarur ekonomikisht dhe të bëjnë sa më shumë aktivitete sensibilizimi në shoqëri ne lidhje me ceshtjet e personave LGBTIQ+”*.

Në Maqedoninë e Veriut u zhvilluan gjithashtu tre intervista. E intervistuar e parë ishte një vajzë Rome biseksuale rreth 22 vjeç e cila jeton e vetme dhe është e punësuar në sektorin privat. Ajo u shpreh se të tjerët kanë nisur të dyshojnë për orientimin e saj seksual kur ishte në shtëpinë

e fëmijës, pavarësisht senë atë kohë ajo vetë e ka mohuar këtë fakt. Për rrjedhojë, në shtëpinë e fëmijës ajo tregon që është përballuar me shumë probleme pasi të tjerët e veçonin. Në mënyrë që të shmangë pasojat e mundshme pohoi që është detyruar që në familje, me kolegët dhe me të njohurit të mohojë orientimin e saj seksual. E intervistuar tregoi që vetëm disa miq të afërt janë në dijeni dhe e kanë pranuar ashtu si është. Megjithatë ajo tregon që nuk ia ka dalë t'i shpëtojë diskriminimit pasi në mjedisin e punës është sulmuar si lesbike dhe i kanë thënë që është e sëmurë dhe duhet të trajtohet nga mjekët. Ajo pohoi gjithashtu që është detyruar të fshihet sepse është e vështirë të jetosh në një vendbanim Romësh në Maqedoninë e Veriut dhe komuniteti ta dijë që je lesbike. Tregoi gjithashtu që është diskriminuar dhe ngacmuar shpesh herë si rome dhe si person LGBTI. Sipas saj, këto sulme kryesisht bëhen më shpesh nga Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut. Në mënyrë që situata të përmirësohet sipas të intervistuarës shteti duhet të angazhohet për përmirësimin e statusit të LGBTIQ+ dhe Romëve në mënyrë që si Romët ashtu edhe LGBTIQ+ të pranohen nga shoqëria. Ndërsa në lidhje me organizatat e shoqërisë civile, e intervistuar u shpreh se duhet të intensifikojnë marrëdhënien me komunitetet respektive.

E intervistuar e dytë ishte një grua Rome, lesbike rreth 38 vjeç e punësuar në sektorin privat dhe që jeton vetëm. Familja e saj ishte në dijeni të orientimit seksual dhe e kishte pranuar. Ndërsa jashtë familjes ajo e ka fshehur orientimin e saj seksual ndaj dhe pohon që nuk i është dashur të përballlet me ndonjë situatë apo akt diskriminues, përveç rasteve kur njerëzit dyshojnë për orientimin e saj seksual. Kjo ndodh idomos mes romësh sepse në rrethet e të njohurve Maqedonas shprehet që nuk ka patur asnjëherë problem të tilla. Ajo mendon që më e mira që mund të bëjë si shteti ashtu edhe organizatat aktualisht është të hapin një zyrë për LGBTIQ+ në Shuto Orizari (një zonë e banuar nga pakica Rome).

Personi i tretë i intervistuar në Maqedoninë e Veriut është një djalë Rom, biseksual rreth 29 vjeç, i punësuar në sektorin publik që aktualisht bashkëjeton me partneren e tij. Pavarësisht se e kishte kuptuar orientimin e tij seksual në moshë të re, ai nuk e ka ndarë këtë më prindërit dhe të afërmit. Në këto rrethana kushtëzuese u shpreh se ka qenë i detyruar të bashkëjetojë me një vajzë, përvojë përmes së cilës ka kuptuar që është biseksual. Ai u shpreh që: *‘Kur u tregovadisa prej kushërinjve të mi për orientimin tim seksual më sugjeruan që të mos ua them prindërve sepse nuk e meritojnë dhe nuk mund ta përballojnë emocionalisht.*

Në shkollë, tregon që është ndjerë keq pasit të tjerët e shihnin me një sy tjetër, me shumë mundësi për shkak të gjuhës së tij të trupit. Ai shprehet: *‘Fatkeqësisht nuk jam “tipi i burrit”. Përveç kësaj jam dhe Rom dhe përshtypja që krijohej nga të tjerët është që Romët janë gay. Megjithatë kam patur edhe miq që më pranonin kështu siç jam dhe vijoje të jem në kontakt me ta. Pavarësisht se vishesha si të gjithë fëmijët e tjerë, gjithmonë më kanë parë me një sy tjetër’.*

Ai u shpreh që sot diskriminimit përpiqet që t’i shpëtojë duke u fshehur dhe duke mos u treguar të tjerëve për orientimin e tij seksual.

‘Unë duhet ta transformoj çdo ditë të jetës sime në një skenë në të cilën sillem si normal, sikur nuk jam një person LGBTIQ+. Jeta ime është si një skenar filmi. Është keq, por jam mësuar të jetoj me të. Jam i diskriminuar edhe nga prindërit e mi sepse ata nuk do më pranonin asnjëherë kështu si jam. Ideja dhe dëshira për “coming out” eventualisht është zhdukur dhe kjo më bën të ndjehem sikur jam frikacak’. -shprehet i intervistuari.

Në lidhje me rolin e shtetit ai mendon se duhen garantuar të drejtat e LGBTIQ+ në mënyrë që të përparohet me procesin e integritimit në Bashkimin Europian. Sipas tij shteti nuk po bën asgjë në këtë drejtim.

Ndërsa në lidhje me orgnizatrat jo fitim-prurëse u shpreh se: *“Vij nga një OJQ, dhe e di se si punojnë. Mendoj se liderat e OJQ-ve po punojnë për xhepat e tyre, vetëm për projektet e tyre, dhe fatkeqësisht asgjë nuk është bërë. Unë nuk e di se ku janë organizatat LGBTIQ+ dhe nuk e di se cilat prej tyre janë akoma aktive. Unë mund të kem nevojë që të flas me dikë por nuk e di se ku janë. Unë mendoj se duhet të ketë më shumë vizibilitet nga organizatat jo-qeveritare që punojnë me personat LGBTIQ+. Njoh shumë persona LGBTIQ+ që po fshihen dhe nuk dinë se ku të kërkojnë ndihmë.”*

Në Serbi u zhvilluan tre intervista. Intervista e parë u zhvillua me një djalë rom, gej, 20 vjeç që jeton vetëm. Ai kishte përfunduar shkollën e mesme dhe punonte në sektorin privat. Kur prindërit e tij u njohën fillimisht me orientimin e tij seksual, ishin shumë kritikë dhe u kanë sugjeruar që t’i nënshtrohet kurave mjekësore ose që ta linin në kishën ortodokse. Ndërsa reagimet e të afërmeve të tjerë kanë qenë të ndryshme. Disa kanë reaguar mirë, ndërsa të tjerët kanë kërkuar që të mos kishin më asnjë kontakt me të.

Ndërsa në lidhje me eksperiencën e tij në shkollë, i intervistuari pohoi që: *“Jam ndjerë vërtet çuditshëm dhe në shumë raste i trishtuar kur fillova të kuptoj se kush jam. Sidomos kur kolegët filluan të ndërprisnin marrëdhëniet me mua ndjeja vetminë dhe përjashtimin social”*.

Si rom, ai pohoi që nuk është ndjerë i diskriminuar për shkak të ngjyrës së hapur të lëkurës krahasuar me Romët e tjerë. Kur u ka rrëfyer të tjerëve që prejardhja e tij është rome vazhdimisht është intimiduar prej pyetjeve si *“Si ka mundësi që je kaq i bardhë?”*; *“Ke përfunduar shkollën dhe po punon, kështu që nuk ka mundësi të jesh Rom”*. Ndërsa për shkak të orientimit seksual ai pohoi që është diskriminuar dhe vijon të diskriminohet por është mësuar ta përballojë këtë situatë. Shteti sipas tij duhet që thjeshtë të zbatojë ligjin, ndërsa mësuesit dhe punonjësit socialë në shkolla duhet të punojnë më shumë me të rinjtë Rom dhe LGBTIQ+.

Personi i dytë i intervistuar ishte 24 vjeç, Rom, gay, jetonte vetëm, kishte përfunduar dy vite të shkollës së mesme dhe punonte në sektorin privat. Momenti që prindërit janë njohur me orientimin e tij seksual ka qenë shumë i vështirë. Në lidhje me këtë ai tregoi: *“Më rrihnin pothuajse çdo ditë. Të afërmit e tjerë reagueshin edhe më keq për fatmirësisht nuk jetonim afër tyre. Miqtë vendosën të largohen me përjashtim të njërit që më pranoi gradualisht”*.

Gjatë kohës së shkollës tregoi që i distancuar nga të tjerët dhe ka preferuar të jetojë i veçuar. Si person LGBTIQ+ pohoi se është diskriminuar dhe vijon të diskriminohet kur të tjerët e marrin vesh orientimin e tij. Ndërsa në raport me përkatësinë e tij romë, si diçka që nuk mund ta fshehë ai pohoi që duke qenë e dukshme kjo cilësi ndikon së pari në sferën e punësimit. Aktualisht ai përballlet me vështirësi të mëdha në raport me strehimin social, meqenëse nuk ka mundësi që t'i përmbushë vetë të gjitha nevojat. Një problem tjetër për të është punësimi pasi është i bindur që është i nën-paguar vetëm sepse është rom. Për shtetin ai shprehet se duhet të ndërhyjë për t'i mbrojtur personat LGBTI nga dhuna e vazhdueshme dhe tu vijë në ndihmë për të zgjidhur problemin e strehimit. Ndërsa në lidhje me organizatat, ai mendon se duhet të jenë më të pranishme në terren, afër komunitetit rom për të ndihmuar më shumë në zgjidhjen e problemeve të tyre.

Konkluzion

Në këtë raport, siç nënvizohet edhe në hyrje, reflektohet më së shumti një pasqyrë e gjetjeve dhe jo interpretimi apo analiza e tyre. Kjo, sepse duke njohur kufizimet e studimit, në aspektin e sasisë së të dhënave të siguruara nga terreni, çdo pretendim për një analizë më të thelluar do të ishte objektivisht e pamundur. Për rrjedhojë, në këtë studim vetëm shtrohen disa linja të

mundshme kërkimi të cilat nevojitet të thellohen në studime të tjera dhe disa gjetje të cilat mund të adresohen në punën e aktorëve që punojnë për pëmirësimin e jetesës së këtyre grupeve.

Për shembull, siç edhe pritej, nga gjetjet e studimit, diskriminimi rezulton të jetë një prej problemeve kryesore, por përmasat, lloji dhe arsyet se përse ndodh, janë të larmishme. Jo rastësisht, në këtë studim mund të konstatohen dallime midis të tre shteteve, midis shtresave të ndryshme brenda të njëjtit grup, midis grupeve të ndryshme brenda të njëjtit shtet për sa i përket llojit të diskriminimit, arsyeve, përmasave etj. Megjithatë është e qartë që më vulnerabël dhe më të ekspozuar ndaj diskriminimit janë personat që i mbartin të dyja përkatësitë.

Në të gjitha vendet rezulton se qeveritë respektive dhe insitucionet përgjegjëse nuk bëjnë mjaftueshëm për të përmirësuar spektrin e të drejtave të këtyre grupeve dhe për përmirësimin e mirëqënies së tyre. Ndërsa, për sa i përket organizatave të shoqërisë civile, megjithëse në këndvështrimin e personave pjesëmarrës, disa prej tyre kanë bërë një punë të mirë, nevojitet që të ndryshojnë qasjen, në mënyrë që të jenë më afër komuniteteve me të cilat punojnë.

Bibliografi

Appadurai Arjun. 2006. *“Frikë nga numrat e vegjël, një ese për gjeografinë e zemërimit”*, përkthyer nga Virgjil Muçi. Tiranë: Instituti Shqiptar i Medias

Barth, Fredrik 1969. *“Ethnic Groups and Boundaries”*. Boston: Little Brown and Company.

Aneks I

Focus-group guiding questions

1. What do you believe are the main problems of Roma and LGBTQI in your country? Why?
2. What do you think are the reasons that the problems you identified exist? How might they be changed? Can you provide examples from NGOs, your community, etc. that tried to make change?
3. To what extent have your problems been addressed? How have your problems been solved? If not, why haven't they been solved?
4. How would you describe individuals who are both Roma and LGBTQ? What is their life like?
5. How does your identity as Roma make you feel? How does your identity as LGBTQI make you feel? How does your identity as both Roma and LGBTQI make you feel?
6. How do you think your government has tried to help the situation you and your community are in? How have they not helped? Why do you think so?
7. How might organizations improve how they work with Roma and LGBTQI? How do you think the communities feel about you and the work your organization does?
8. How can we support these communities to elevate their voices, needs, and have them be a part of the change process

Interview Questionnaire

I. General data

1. Gender

Man	<input type="checkbox"/> 1
Woman	<input type="checkbox"/> 2
Transgender man	<input type="checkbox"/> 3
Transgender woman	<input type="checkbox"/> 4
Genderqueer	<input type="checkbox"/> 5
Gender fluid	<input type="checkbox"/> 6
Other	<input type="checkbox"/> 7

2. Age _____ (in years)

3. How many years of education have you completed? _____ (number of years completed)

4. What is your civil status?

Single	<input type="checkbox"/> 1
Married	<input type="checkbox"/> 2
Divorced	<input type="checkbox"/> 3
Widowed	<input type="checkbox"/> 4
Cohabiting	<input type="checkbox"/> 5
Other (Specify _____)	<input type="checkbox"/> 6

5. How many members are there in your family? _____ (persons)

6. How much monthly income does your family have?

No income	<input type="checkbox"/> 1
Up to 160 Euro	<input type="checkbox"/> 2
161 Euro – 320 Euro	<input type="checkbox"/> 3
321 Euro- 480 Euro	<input type="checkbox"/> 4
More than 480 Euro	<input type="checkbox"/> 5

7. Who do you live at the moment with?

Alone	<input type="checkbox"/> 1
With family	<input type="checkbox"/> 2
With partner	<input type="checkbox"/> 3
With friends	<input type="checkbox"/> 4
Other (Specify _____)	<input type="checkbox"/> 5

8. Are you employed at the moment?

No, I have never been	<input type="checkbox"/> 1
Not at the moment	<input type="checkbox"/> 2
Yes, I am employed in the private sector	<input type="checkbox"/> 3
Yes, I am employed in the public sector	<input type="checkbox"/> 4
Yes, I am self-employed	<input type="checkbox"/> 5
Student	<input type="checkbox"/> 6
Pensioner	<input type="checkbox"/> 7
Other (Specify _____)	<input type="checkbox"/> 8

9. What is the source of your income?

Salary	<input type="checkbox"/> 1
Contract-based fee	<input type="checkbox"/> 2
Remittance from abroad / from the parents	<input type="checkbox"/> 3
Welfare benefits	<input type="checkbox"/> 4
Other	<input type="checkbox"/> 5

10. How much individual monthly income do you have?

Up to 160 Euro	<input type="checkbox"/> 1
161 Euro – 320 Euro	<input type="checkbox"/> 2
321 Euro- 480 Euro	<input type="checkbox"/> 3
More than 480 Euro	<input type="checkbox"/> 4

II. Relationship with identity

11. What is your ethnicity?

Roma	<input type="checkbox"/> 1
Egyptian	<input type="checkbox"/> 2
Albanian	<input type="checkbox"/> 3
Other, specify _____	<input type="checkbox"/> 4

12. Please, describe briefly when and how did you understand you are Roma or Egyptian?

13. What is your sexual orientation?

Lesbian	<input type="checkbox"/> 1
Gay	<input type="checkbox"/> 2
Bisexual	<input type="checkbox"/> 3
Pansexual	<input type="checkbox"/> 4
Heterosexual	<input type="checkbox"/> 5

14. Please, briefly describe when and how did you realize your sexual orientation and/or gender identity?

15. How did you feel in those moments?

16. Do others know about your sexual orientation and/or gender identity?

Yes 1

No 2

17. In which conditions, did others learn about this?

18. How did your relatives and other people react when they realized or you told them about your sexual orientation and/or gender identity?

19. How do you/did you feel at school in relation to others?

20. Do you feel discriminated or excluded and how? Please tell us, in which way you are discriminated against by others?

21. Please tell us, what do you do to cope with discrimination?

III. Everyday life and belonging

22. How much does being Roma/Egyptian and also LGBT affect your daily life?

23. Please tell us concretely what difficulties or problems do you face actually?

24. Do your ethnicity and your sexual orientation and/or gender identity affect the difficulties you actually face in your life? Please tell us concretely how this happens.

25. How do you spend your free time?

26. Please tell us concretely what difficulties do you face as a consequence of being Roma or Egyptian?

27. What about the difficulties you face as a consequence of your sexual orientation and/or gender identity?

28. What do you think the civil society organizations should do to improve your life?

29. What do you think the state authorities should do to improve your life?

30. What do you think you should and can do to improve your life and the life of others who are in similar situation as you?
